

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6652
E mërkurë, 13 korrik 2022
çmimi 0.40 €

Konvoji i EULEX-it, me ndihma për Ukrainën, niset nga Kosova



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E MËRKURË) NË HAGË MBAHET KONFERENCA E 13-të
NDAJ DREJTUESVE TË UÇK-së

LIDERËT E UÇK-së SOT DALIN PARA SPECIALES



Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, do të dalin sot (e mërkurë) para trupit gjykues në Gjykatën Speciale në kuadër të konferencës së 13-të statusore ndaj tyre. Në këtë konferencë është paraparë të diskutohet për zbulimin e provave, hetimet e mbrojtjes, hapat e tjerë të tyre si dhe për propozimet për racionalizimin e procesit gjyqësor.

Drejtuesit e UÇK-së janë duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020, pavarësisht se avokatët e tyre kanë kërkuar të mbrohen në liri. Avokatët e tyre disa herë e kanë akuzuar ZPS-në për fshehjen e deklaratave shfajësuese për drejtuesit e UÇK-së. Po ashtu, ata e kanë akuzuar ZPS-në për zvarritjen e procesit ndaj klientëve të tyre

AKTUALE



POLICIA ME AKTIVITETE VETËDIJESUESE "FESTO ME ZEMËR, JO ME ARMË"

KONJUFCA VLERËSON MBËSHTETJEN E MBRETËRISË SË BASHKUAR PËR KOSOVËN

EKONOMI



ATK-ja PËR GJASHTË MUAJ MBLODHI 76.8 MILIONË EURO BORKHE

VLORA E BOSHATISUR NË MES TË SEZONIT TURISTIK, SHKAK ÇMIMET E LARTA

VLERA E EUROS BARAZOHET ME ATË TË DOLLARIT

SPORT



16 LOJTARË RINOVOJNË KONTRATAT ME DUKAGJININ, 9 TË TJERË LARGOHEN



KOSOVË, PASOJAT E SHKALLËS SË LARTË TË EMIGRIMIT

FAQE 3



SHOIPËRIA I HAP DITËN JESHILE NATO-S PËR NJË BAZË TË RE DETARE

FAQE 7

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB: Mbi 71 milionë persona jetojnë në varfëri

NJU-JORK, 7 KORRIK - Rritja e çmimeve të ushqimit dhe energjisë i ka shtyrë mbi 71 milionë persona në mbarë botën në varfëri që nga fundi i shkurtit kur Rusia nisi luftën ndaj Ukrainës, tha një agjenci e Kombeve të Bashkuara.

Në raportin e Programit për Zhvillim të OKB-së (UNDP-së), i publikuar më 7 korrik, gjithashtu paralajmërohet për rrezikun e trazirave shoqërore në disa vende për shkak të krizës ekonomike.

Achim Steiner, administrator i kësaj agjencie, tha se analizat e bëra në 159 shtete në zhvillim tregojnë për rritje të çmimeve të mallrave këtë vit që kanë goditur pjesë të Ballkanit, Afrikës Nën-Sahariane, Azisë dhe gjetkë. “Kostoja e jetesës po çon miliona njerëz në varfëri, madje edhe uria po përhapet me shpejtësi marramendëse”, tha ai në një deklaratë. “Kërcënimi i rritjes së trazirave shoqërore po rritet dita-ditës”, shtoi ai.

Ukraina është prodhuese e

madhe e drithërave dhe eksportuese e këtyre produkteve dhe dërgesat e saj ushqimore janë kritike për shumë shtete në Lindjen e Mesme dhe Afrikë. Por, portet e saj në Detin e Zi janë bllokuar nga forcat ruse, duke bërë që të rriten çmimet e ushqimeve dhe duke shtyrë dhjetëra-miliona njerëz drejt varfërisë.

Rusia dhe Ukraina së bashku përbëjnë pothuajse çerekun e eksporteve globale të grurit dhe mbi gjysmën e eksporteve të vajit të lulediellit.

Çmimet e energjisë, po ashtu, janë rritur pas paqartësive lidhur me luftën, po ashtu për shkak se Rusia ka ndërprerë disa eksporte të naftës dhe gazit. Para luftës Rusia ishte eksportuesja më e madhe në botë e gazit natyror dhe eksportuesja e dytë e naftës së papërpunuar.

Sanksionet perëndimore ndaj Ruisë, që janë vendosur për ta ndëshkuar Moskën për shkak të pushtimit të Ukrainës, kanë



përkeqësuar inflacioniste.

Disa shtete janë goditur më së keqi nga inflacioni, tha kjo agjenci e OKB-së, përfshirë Haitin, Argjentinën, Egjiptin, Irakun, Turqinë, Filipinet,

presionet

Ruandën, Sudanin, Kenian, Shri Lankën dhe Uzbekistanin.

Në shtetet si Afganistani, Etiopia, Mali, Nigeria dhe Jemeni, ndikimi i inflacionit është më i madh për shkak se këto shtete veçse kanë nivele të

larta të varfërisë.

Numri i përgjithshëm i personave që jetojnë në varfëri ose janë në prag të varfërisë është mbi 5 milionë ose nën 70 për qind të popullsisë së botës, tha UNDP.

Rriten për 15 % importet e naftës në Gjermani, dyfishohet fatura

BERLIN, 7 KORRIK - Vëllimet e importit të naftës së papërpunuar gjermane u rritën për 14.6 për qind në katër muajt e parë të 2022-s pasi ekonomia u rikuperua nga ndikimi i pandemisë Covid-19 dhe fatura u dyfishua për shkak të çmimeve më të larta, treguan të dhënat zyrtare të mërkurës.

Rusia mbeti furnizuesja kryesore, duke mbajtur një pjesë prej 35-përqindësh të importeve të naftës të Gjermanisë në këtë periudhë, treguan statistikat mujore nga Zyra e Tregtisë së Jashtme BAFA. Importi me 21.5 për qind u pasua nga Deti i Veriut Britanik dhe Norvegjez, ndërsa importet



nga anëtarët e Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) kontribuuan 17.7 për qind.

Pjesa e mbetur u nda mes burimeve të tjera, duke përfshirë Kazakistanin dhe Shtetet e Bashkuara.

BAFA publikon të dhënat e importit me dy muaj vonesë.

Kjo do të thotë se ndikimi i pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt, i cili ka çuar në sanksione ekonomike ndaj Ruisë dhe kundër veprimeve në rrjedhat e energjisë, do të fillojë të shfaqet gradualisht.

Importet gjermane të naftës në janar - prill nga të gjitha origjinat u rritën në 28.5 milionë tonë nga 24.9 milionë sa ishin në muajt e vitit 2021, tha BAFA.

Gjermania shpenzoi 18.5 miliardë euro (18.81 miliardë dollarë) për importet e papërpunuara në katër muajt, 99 për qind më shumë se një vit më parë.

Çmimi mesatar i paguar për ton në kufi u rrit 74 për qind në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke qëndruar në 647.57 euro, tha BAFA.

Çmimet e naftës Brent në tregun global zvogëluan disa terrene të humbura pas një shitjeje prej 9-përqindësh të martën nga frika në rritje për recesion dhe bllokime në Kinë. Çmimet ishin rimëkëmbur fuqishëm gjatë vitit 2021 dhe në fillim të 2022-s dhe arritën nivelin e tyre më të lartë që nga viti 2008 në mars, të nxitur nga shqetësimet për ndikimin e pushtimit rus të Ukrainës Ato janë ende në nivelet më të larta në këto tetë vjet.

Ukraina i kërkon shpjegim Turqisë për anijen ruse

KIEV, 7 KORRIK - Ministria e Jashtme ukrainase tha më 7 korrik se anija ruse që bartte drithë ukrainase është lejuar që të largohet nga porti turk Karasu.

Ukraina tha se lejimi i anijes që të largohet nga porti i Turqisë ishte një veprim “i papranueshëm” dhe për këtë temë do të thërrasë në bisedë ambasadorin e Turqisë. “Na vjen keq që anija ruse Zhibek Zholy, e cila ishte e mbushur plotësisht me drithin e vjedhur

ukrainas, është lejuar që të largohet nga porti Karasu, pavarësisht të dhënave që u janë paraqitur autoriteteve turke”, tha zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme ukrainase, Oleg Nikolenko, përmes një postimi në “Twitter”.

“Ambasadori turk në Kiev do të ftohet nga Ministria e Jashtme e Ukrainës për ta sqaruar këtë situatë të papranueshme”, shtoi ai.

Më 4 korrik zyrtarët në Turqi

konfirmuan se kishin ndaluar një anije mallrash ruse dhe se po hetonin pretendimet e Ukrainës se ajo po transportonte grurë të vjedhur. Ukraina është një prej prodhuesve dhe eksportuesve më të mëdha në botë të drithërave. Por, Rusia, që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, ka bllokuar portet ukrainase, duke ndikuar në rënien e furnizimeve botërore të ushqimit dhe rritjen e çmimeve.



Kosovë, pasojat e shkallës së lartë të emigrimit

PRISHTINË, 12 KORRIK - Isuf Mehani nga Prishtina ka një vit që po përpiket të marrë një vizë në ambasadën gjermane, e cila do t'i mundësonte të vazhdojë jetën në Gjermani.

Ai thotë se është i zhgënjyer nga mungesa e mundësive për jetë me dinjitet në Kosovë, dhe se arsyeja për të cilën dëshiron ta lërë vendin është që të sigurojë kushte më të mira të jetesës për të, gruan dhe katër fëmijët e tij. “Kjo është një alternativë, tash prej të gjitha të këqijave ne duhet të zgjedhim të keqen më të vogël. E di se kjo nuk është e mirë për askënd, por është e domosdoshme, jo që këtë e dëshiron dikush, se nuk besoj që dikush e dëshiron vërtetë”, thotë Isufi. Ai thotë se para disa vitesh udhëhiqte një ndërmarrje biznesi, por u detyrua ta ndërpresë atë për shkak të një lënde në gjykatë. Ndërsa pret përgjigjen e gjykatës, pa një punë të rregullt dhe me çmimet në ngritje, Isufi thotë se jeta e përditshme është bërë shumë sfiduese. “Arsyeja

kryesore është se nuk ka funksionuar gjykata e policia deri tash, dhe nuk po pritet ende të ndryshojë diçka. Personalisht kam lëndë në gjykatë prej vitit 2010, tash mbi 10 vjet po bëhen”, thotë ai.

Isufi është vetëm një nga qytetarët e shumtë që presin para ambasadave të huaja në Prishtinë, me synim ikjen jashtë shtetit.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm në vitin 2021 nga Kosova kanë emigruar 42 mijë e 728 veta, shumica prej tyre në rrugë të ligjshme dhe kryesisht për në vendet e Bashkimit Evropian.

Një hulumtim i organizatës Demokraci Plus në Prishtinë, nxjerr në pah se numri i lartë i largimit të rinjve nga Kosova do të sjellë pasojat të rënda për të ardhmen e vendit.

Albana Rexha, analiste e politikave publike në këtë organizatë, tha për “Zërin e Amerikës” se motivet që i nxisin qytetarët të largohen nga Kosova lidhen kryesisht me

papunësinë dhe situatën ekonomike.

Dukuria e emigrimit, thotë ajo, është më e përhapur tek të rinjtë e arsimuar. “Kostoja e përgjithshme e arsimit të njerëzve të cilët largohen nga Kosova brenda vitit varion nga 180 milionë deri në 205 milionë euro, varësisht nga struktura e arsimit të njerëzve që emigrojnë. Do të thotë ajo që ishte dashur të jetë investim për shtetin, shndërrohet në shpenzim”, thotë ajo.

Përveç humbjeve financiare, Rexha thotë se Kosova po humb edhe fuqi punëtore. “Kjo është humbje e potencialit ekonomik për vendin, gjithë ky largim. Sidomos emigrimi i individëve me arsim të lartë e paraqet humbjen e potencialit për vendin, e paraqet rënien e atraktivitetit të Kosovës për investitorë të huaj dhe në të ardhmen mund të ketë probleme sa i përket produktivitetit dhe inovacionit në përgjithësi në vend. Të gjitha këto janë humbje që i paraqiten

vendit në të ardhmen”, thotë ajo.

Pasojat e ikjes së qytetarëve jashtë vendit, kanë filluar të ndihen në sektorin e bareve dhe restoranteve thotë Petrit Kllloqi, kryetar i shoqatës së gastronomëve.

Ai i tha “Zërit të Amerikës” se kjo është kriza më e madhe e mungesës së punëtorëve në 16 vjet, që ai ka qenë pjesë e këtij sektori. “Nuk ka qenë kurrë më vështirë se tash. Tani ndër gjërat kryesore që kanë ndodhur është rritja e shpenzimeve, e kemi parasysh se punëtorëve iu ka mbetur paga e njejtë, ndërsa iu janë rritur të gjitha shpenzimet bazike si nafta, ushqimi e gjithçka tjetër, prandaj nuk po mund të mbijetojnë me këto paga. Ne si sektor i gastronomisë kemi nisur me ngritje të pagave por prapë se prapë nuk janë në pikën e dëshiruar”, thotë ai.

Kllloqi thotë se nëse ky trend vazhdon, shumë biznese do të detyrohen të marrin punëtorë nga jashtë ose të kalojnë në

vetëshërbim. “Po e shohim që edhe te ne do të vijë ajo ditë shpejt kur do të na duhet të marrim punëtorë nga jashtë, jemi pra në prag të saj. Te ne ende nuk ka ndodhur liberalizimi dhe nuk e kemi vuajtjen që e ka sektori jonë në vendet fqinje mirëpo edhe ajo pritet. Tjetra është që do të kalojnë në self-service shumica e bizneseve, ku reduktohet numri i punëtorëve. Po shpresojmë që shteti do të na subvencionojë, në këtë rast të ulë TVSH-në (Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) në 8 për qind dhe ato para që i përfitojnë bizneset t'i shndërrojnë në përfitim të punëtorëve në gastronomi ose sektorë të tjerë”, thotë ai.

Sipas të dhënave nga Ministria e Brendshme për vitin 2020, Gjermania prin me numrin e lejeve të qëndrimit të lëshuara për shtetasit e Kosovës. Pjesa dërmuese e tyre janë dhënë për bashkim familjar, ndërsa pjesa tjetër për qëllime punësimi, arsimimi apo të tjera.



Spartak Ngjela: Saliu nuk i fiton dot zgjedhjet



TIRANË, 12 KORRIK - Avokati Spartak Ngjela është shprehur se Sali Berisha nuk mund t'i fitojë kurrë zgjedhjet dhe po 'lufton' kot me Partinë Demokratike.

Në studion e “Top Story” me Sokol Ballën, ai tha se protestën Berisha e organizuar vetëm për të treguar sesa i fortë është dhe sesa mbështetje ka nga qytetarët, pavarësisht non-gratës amerikane.

Madje, Ngjela tha se Berisha e ngriti flamurin kombëtar në

shesh vetëm për të treguar se po kalon në nacionalizëm anti-amerikan. “Në protestë nuk ishin shumë se 2 mijë e 500 persona. Deri tek ura ishin. Ai e organizoi protestën për të thënë unë jam i fortë. Sali nuk kërkon zgjedhje, pro të tregojë që unë kam mbështetje popullore. Pse e mori flamurin, po i thotë atyre unë do të kalojë në nacionalizëm anti-amerikan. Filloi të gënjente nga katër anët, por nuk e gënjen optikën e amerikanëve. Nuk fiton dot

zgjedhjet, 28% është PD-ja sot në të dy krahët. Pse lodhet me PD-në kur nuk fiton dot. Pse e shkatërron të djathtën. Saliu ka pushtuar të djathtën. Nuk mund të flitet nëse nuk më jep doktrinën sesi të fitosh zgjedhjet. Zgjedhjet e parakohshme nuk bëhen dot nga këta opozitarët, atëherë si do e ndryshosh këtë gjendje. Ka shumë raste në perëndim, kur kanë humbur pushtetin lokal, kanë shkuar në zgjedhje të parakohshme”, ka thënë Ngjela.



SOT (E MËRKURË) NË HAGË MBAHET KONFERENCA E 13-TË NDAJ DREJTUESVE TË UÇK-SË

Liderët e UÇK-së sot dalin para Speciales

Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, do të dalin sot (e mërkurë) para trupit gjykues në Gjykatën Speciale në kuadër të konferencës së 13-të statusore ndaj tyre. Në këtë konferencë është paraparë të diskutohet për zbulimin e provave, hetimet e mbrojtjes, hapat e tjerë të tyre si dhe për propozimet për racionalizimin e procesit gjyqësor. Drejtuesit e UÇK-së janë duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020, pavarësisht se avokatët e tyre kanë kërkuar të mbrohen në liri. Avokatët e tyre disa herë e kanë akuzuar ZPS-në për fshehjen e deklaratave shfajësuese për drejtuesit e UÇK-së. Po ashtu, ata e kanë akuzuar ZPS-në për zvarritjen e procesit ndaj klientëve të tyre

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 12 KORRIK - Muaji maj ka qenë koha e fundit kur liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë dalë para gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Speciale në Hagë. Në kuadër të procesit gjyqësor ndaj tyre, sot (e mërkurë) do të mbahet konferenca e 13-të më radhë ndaj katër drejtuesve të UÇK-së, të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim nga fillimi i nëntorit të vitit 2020. Kjo konferencë do të fillojë në orën 13:30, por e njëjta pritjet do të transmetohet me 45 minuta vonesë.

Gjatë kësaj konference, në urdhrin për caktim të saj, gjykatësi paraprak ka paraparë se do të diskutohet për zbulimin

e provave, hetimet e mbrojtjes dhe hapat e tjerë të tyre, si dhe për propozimet për racionalizimin e çështjes.

Konferenca mbi ecurinë e çështjes gjyqësore parashihet me rregullën 96 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK).

Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Prokuroria është duke pretenduar se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë dhe Semetishtë.

Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen se kanë ndodhur në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi

dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor ose çnjerëzor, torturë, vrasje. Ndërsa si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, veprat e tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin. Kurse për krimet që pretendon që kanë ndodhur në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen, ndërsa si krime kundër njerëzimit ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjen e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë ka deklaruar edhe Veseli

në paraqitjen e tij më 10 nëntor, ashtu sikurse Selimi më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor të vitit 2020. Që nga arrestimi i tyre më 5 nëntor të vitit 2020 ata janë duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë ani pse avokatët e tyre kishin kërkuar disa herë lirin e tyre nga paraburgimi dhe mbrojtjen në liri.

Në njërin nga konferencat statusore, avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, kishte thënë se nuk i beson më Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ai duke iu referuar një deklaratë të ish-ambasadorit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, kishte kërkuar lirin e drejtuesve të UÇK-së. Sipas tij, deklarata shfajësuese e ambasadorit Everts për liderët e UÇK-së është mbajtur fshehtë nga ZPS-ja.

Më tutje, ai kishte thënë se prokuroria ka marrë në pyetje qindra ushtarë të UÇK-së, por mbrojtja asnjëherë nuk i ka parë ato dokumente. Po ashtu, avokati i Thaçit e kishte akuzuar ZPS-në se ka marrë shumë informacione dhe dokumente nga Shërbimi Inteligent i Serbisë (UDB). "ZPS-ja ka të bëjë me shërbimin e fshehtë serb nga i cili ka marrë shumë materiale, ka

dëgjuar dhe ka marrë shumë akuza që sigurisht që nuk e gjetën rrugën deri në aktakuzë, që bashkëpunojnë me Rusinë siç po ndodh në Ukrainë, por kjo është një gjë tjetër. Siç thashë, po merr prova materiale nga serbët që, padyshim, do ta cenojnë kredibilitetin e ZPS-së", kishte thënë avokati i Thaçit.

Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, kishte pretenduar se shërbimet sekrete serbe edhe në Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë kanë ndërhyrë në dëshmi, duke i ndryshuar ato dhe kanosur dëshmitarët. Po ashtu, Emmersoni kishte hedhur akuza të ashpra ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Gjykatën Speciale në lidhje me protokollin e propozuar nga kjo zyrë për kontaktet me dëshmitarët.

Emmersoni kishte thënë se pretendimet e ZPS-së për ndërhyrje të mundshme të mbrojtjes të dëshmitarët janë qesharake dhe fyese. "Janë komente fyese. Nuk përputhen fare me rregullat dhe dua ta trajtoj sepse është koment serioz. Ju duhet ta shikoni mënyrën se si paraqitet çështja te prezumimi i pafajësisë. Çështja kryesore është proporcionaliteti i kësaj që propozohet. Prokurori tha që nuk e dinte nëse e kishte të drejtën t'i përfaqësonte viktimat. Ai nuk e ka këtë të drejtë. Siç

Konjufca vlerëson mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga nënkryetarja, Saranda Bogujevci, deputetja Fitore Pacolli-Dalipi dhe ambasadori Ilir Kapiti, ka pritur të martën në takim një delegacion nga Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar, kryesuar nga deputetja Harriett Baldwin. Në takim, ndër të tjera, u diskutua për zhvillimet politike, mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit, si dhe për avancimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Konjufca, pasi i njoftoi deputetët britanikë me rrjedhat e punës së legjislativit dhe trupave të tij, vlerësoi lart mbështetjen koherente të

Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën në të gjitha fazat vendimtare të shtetndërtimit dhe fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar, duke theksuar rolin e veçantë të këtij shteti mik për lirinë, pavarësinë dhe rimëkëmbjen e shtetit tonë. Kreu i Kuvendit po ashtu kërkoi përkrahjen e mëtejme të Mbretërisë së Bashkuar për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Deputetët e parlamentit britanik, të cilët po qëndrojnë për vizitë zyrtare në Kosovë, falënderuan Konjucën për pritjen dhe shprehën përkushtimin për intensifikimin e bashkëpunimit në sektorë dhe fusha specifike, përfshirë edhe këmbimin e praktikave të mira mes parlamenteve respektive.



AKP-ja dhe KGJK-ja nënshkruajnë marrëveshje për bashkëpunim ndërinstitucional



PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) kanë nënshkruar të martën memorandum mirëkuptimi me qëllim të ndihmës së ndërsjellë për përshtetimin e proceseve të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Memorandumi i mirëkuptimit u nënshkrua nga kryesuesi i Bordit i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Nazmi Mikullovi dhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, të cilët, duke vlerësuar bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, theksuan se me memorandumimin e nënshkruar do të shtohet efikasiteti në shqyrtimin e lëndëve për përmbylljen e procesit të likuidimit të ndërmarrjeve nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Qëllimi i këtij memorandum është përcaktimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me synim efikasitetin dhe ekonomizimin e procedurave të cilat parashihet të arrihen me angazhimin e disa Ofruesve të Shërbimeve/Juristëve të diplomuar, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, lidhur me çështjet administrative në procesin e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. AKP si agjenci e pavarur dhe KGJK si institucion i pavarur shprehën gatishmërinë e vazhdimin të bashkëpunimit të mëtejshëm ndërinstitucional me qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta që është adresimi me kohë i lëndëve pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

thotë prokuroria, për çfarë është ky protokoll dhe cila është metodologjia? Prokuroria thotë se do të shmangë ritraumatizimin e dëshmitarëve dhe ta ruajë integritetin e tyre fizik, kishte thënë ai, duke kërkuar të përjashtohet nga procesi gjyqësor çdo person i cili nuk është viktimë. "Përse përfshihen dëshmitarët në këtë protokoll? Nuk ka asnjë arsye të besoj se mbrojtja do t'i korruptojë ata. Është për të qeshur dhe fyese, prandaj nuk duhet të merren seriozisht. E kundërta është e vërtetë. Për ndërkombëtarët që do të thirren si dëshmitarë, ky sistem nuk duhet të zbatohet. Pra,

minimumi është se duhet të përjashtohet çdo person që nuk është viktimë. Gjithçka që mund të bëhet për ta bërë numrin e menaxhueshëm, ndryshe do të kemi vonesë për dy vjet. Është një proces ku secila palë duhet të ketë besim që ta paraqesë çështjen e vet. Nëse prokuroria thotë se nuk mund t'ia kesh besën mbrojtjes, kjo është për të qeshur. Kam frikën se gjithçka mund të rëzohet sepse gjithçka bazohet në besimin në mes të palëve. Këto janë kërcënime për bashkëpunimin e dëshmitarëve", kishte thënë ai. Më tutje, avokati i Veselit kishte thënë se ZPS-ja ka orkestruar takime me ambasadorët

evropianë për çështjen e të akuzuarve dhe, sipas tij, kjo është diçka shokuese. "Sipas tyre, ne nuk duhet ta kemi besën dhe ne jemi njerëz jo të duhur. Çështjet e ngritura nga mbrojtja kundër prokurorisë lidhen me deklaratat jo të sakta lidhur me kohëzgjatjen e procedurave për periudhën paraprake dhe shanset e lirim të paraprak. Prokuroria e ka keqorientuar gjykatën në shumë mënyra. Prokuroria ka orkestruar takimin e ambasadorëve evropianë në lidhje me të akuzuarit. Kemi pasur zhvillime të tmerrshme sa i përket sjelljes së prokurorisë. Është një shok dhe tronditje se

si prokuroria është lejuar të silltet në këtë mënyrë. Të thuash se unë jam një person që do të kryej krim në përgatitjen e mbrojtjes është e turpshme. Prokuroria ka humbur çdo arsye dhe logjikë dhe është e dëshpëruar", ka thënë Emmersoni. Që nga nëntori i vitit 2020 liderët e UÇK-së janë vizituar nga familjarët, bashkëlloftëtarët dhe miqtë e tyre. Nga bartësit e institucioneve liderët e UÇK-së i kanë vizituar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, deputetë dhe ministra. Po ashtu, për vizitë në Hagë ka qenë edhe kryeministri

i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka takuar Hashim Thaçin, për të cilin kishte thënë se e kishte marrë malli. Thaçi këto ditë është vizituar edhe nga prindërit, të cilët janë takuar me të pas një kohe të gjatë. Kujtojmë se gjatë qëndrimit në Hagë, Kadri Veseli ka humbur të dy prindërit. Gjykata Speciale as nuk e kishte lejuar të merrte pjesë në varrimin e tyre. Ai ishte liruar përkohësisht vetëm pasi prindërit e tij ishin varrosur. Përpos Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.

QKMF-ja e Hanit të Elezit furnizohet me barna, pas dyshimeve për helmim nga uji

HANI I ELEZIT, 12 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, kanë bërë furnizimin me barna në QKMF-në, në Han të Elezit, në kuadër të kërkesave për ndihmë emergjente, sa i përket dyshimeve për helmim nga uji. Në QKMF-në e Kaçanikut

janë dërguar barna dhe produkte medicinale nga Spitali i Ferizajt, derisa në atë të Hanit të Elezit janë dërguar nga QKUK-ja. “Po ashtu, sa i përket situatës së krijuar të gjitha komunat për rreth Hani të Elezit, si Vitia, Ferizaj etj, janë në gjendje gatishmërie për të ndihmuar komunën e Hanit të Elezit, për tejkalimin e kësaj situatë,

ku dyshohet se disa qytetarë janë helmuar më ujë të pijes”, ka njoftuar MSh-ja. Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet relevante janë duke e përcjellë gjendjen në komunën e Hanit të Elezit dhe në atë të Kaçanikut, në mënyrë që t’ju ofrojnë shërbime sa më të duhura qytetarëve të këtyre vendeve, por edhe më gjerë.



Policia me aktivitete vetëdijësuese “Festo me zemër, jo me armë”

GJILAN, 12 KORRIK (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, Njësi Rajonale i Komunikacionit Rrugor, njësi me Bicikleta dhe njësi i Komunitetit të Stacionit Policor në Gjilan, kanë zhvilluar të martën një fushatë vetëdijësuese në qytetin e Gjilanit.

Gjatë këtij aktiviteti përpos shpërndarjes së fletëpalosjeve me disa këshilla për vetësiguri, në disa lokacione të cilat janë më të frekuentuara kanë vendosur poster të cilët bëjnë thirrje vetëdijësuese tek qytetarët me moton “Festo me zemër, jo me armë (sa më pak armë, më

pak tragjedi)” dhe “Të kujdesemi për sigurinë”. Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan inkurajon qytetarët dhe mediet që për të gjitha dukuritë negative që i vërejnë të njoftojnë stacionin më të afërm të policisë, apo përmes aplikacionit digjital “Lajmëro Policinë”.

“Burgu i idealit” në ish-qendrën e paraburgimit

PRISHTINË, 12 KORRIK - Video, fotografi, artefakte, këngë të shkruara, vizatime e thënie nga ish të burgosur politikë janë prezantuar në ekspozitën e përkohshme “Burgu i idealit” në ish-qendrën e paraburgimit në Prishtinë. Kjo qendër ishte vendi ku mijëra ish të burgosur shqiptarë kanë

përjetuar tortura nga regjimi serb. Teksa ekspozita është e përkohshme, me vendim të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku, ish-qendra e paraburgimit të Prishtinës kthehet në muze dhe do të jetë e hapur për të gjithë qytetarët çdo ditë, përveç të hënave.



Dy të vdekur nga koronavirusi në Kosovë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Dy persona kanë vdekur nga koronavirusi të martën në Kosovë sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa janë raportuar edhe 175 raste të reja me të infektuar. Ministria e Shëndetësisë tha se, në bazë të 467 mostrave të

testuara gjatë 24 orëve, 37 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Aktualisht, janë 2,184 raste aktive me koronavirus në Kosovë. Në 24 orët e kaluara, Ministria e Shëndetësisë tha se janë shëruar 105 pacientë.

Numri i rasteve me koronavirus në Kosovë ka nisur të rritet në gjysmën e dytë të qershorit. Muajt e pranverës kanë qenë kryesisht të qetë sa u përket infektiveve - ka pasur ditë me zero raste. Shkalla e infeksionit është në rritje edhe në vende të tjera të Ballkanit dhe më gjerë.



Shqipëria i hap dritën jeshile NATO-s për një bazë të re detare

TIRANË, 12 KORRIK- Shqipëria i ka dërguar një sinjal paralajmërues presidentit rus, Vladimir Putin përpara një takimi me NATO-n në lidhje me një bazë të re detare në vend, sipas gazetës britanike "Express" (express.co.uk). Kryeministri Edi Rama do të takohet me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg për të diskutuar propozimin. Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, filloi punën për shndërrimin e një baze ish-sovjetike në një bazë ajrore të NATO-s, duke çimentuar lidhjet e Tiranës me Brukselin. Rama do të takohet me Stoltenberg të mërkurën për të diskutuar projektin. Porti do të jetë i vendosur në Porto Romano, Durrës, 40 minuta nga kryeqyteti dhe do të përfshijë një seksion tregtar

dhe një bazë detare ushtarake. Financimi do të sigurohet si nga shteti shqiptar ashtu edhe nga NATO. Shqipëria shpenzon aktualisht rreth 1,53 për qind të PBB-së së saj vjetore për mbrojtjen. Duke folur për planin, Rama tha se "Ne do të kthehemi së shpejti në Bruksel për të vazhduar diskutimet në lidhje me propozimin tonë... për instalimin e një baze detare të NATO-s në portin e ri në Durrës". Në maj, Rama tha se qeveria e tij i kishte ofruar NATO-s bazën detare të Pashalimanit. E vendosur në jug të Vlorës, rreth 170 kilometra nga Durrësi, ajo ishte e vetmja bazë e Bashkimit Sovjetik në Mesdhe gjatë viteve '50-ta, në një kohë kur regjimi komunist i Shqipërisë ishte në linjë me Moskën. Pas rënies së komunizmit, ajo



u rindërtua me ndihmën e Turqisë, e cila ruajti të drejtën e përdorimit të saj. Marina

shqiptare ende sot e përdor bazën për disa operacione dhe stërvitje. Ky opsion duket se

është paraqitur në favor të Porto Romanos.

Konvoji i EULEX-it nis nga Kosova me ndihma për Ukrainën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 KORRIK - Një konvoj i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, i përbërë nga 12 automjete, është nisur të martën për Ukrainë. Këto automjete do t'i dhurohen Policisë Shtetërore kufitare të Ukrainës. Ky donacion është blerë nga stafi ndërkombëtar dhe ai lokal i EULEX-it, tha shefi i këtij misioni, Lars-Gunnar Wigemark, në ceremoninë para nisjes së konvojit. Sipas tij, këto ndihma përmbajnë gjëra ushqimore dhe joushqimore, si: veshmbathje, thasë për fjetje, produkte farmaceutike dhe të



higijenës personale. "Stafi ynë ka mbledhur po ashtu para të gatshme, për mbështetje të familjeve ukrainase. Jam krenar me stafin dhe iniciativën e tyre, për të treguar një praktikë solidariteti me

Ukrainën", ka thënë Wigemark. Ministria e Jashtme dhe e Diasporës së Kosovës, Donika Gërvalla, tha se Kosova e di nëpër çfarë po kalon Ukraina dhe se "ne qëndrojmë

fuqishëm në anën e Ukrainës". "Ne në Kosovë e kuptojmë saktë nëpër çka po kaloni, sepse lufta në Kosovë nuk ka shumë kohë që ka ndodhur dhe qytetarët tanë e mbajnë mend fare mirë", ka thënë ajo. Gërvalla përmendi edhe programin e strehimit të gazetarëve ukrainas në Kosovë, si dhe sanksionet e ndërmarra. "Jam krenar se BE-ja ka reaguar në mënyrë të qartë dhe të fuqishme. BE-ja është e bashkuar në mbështetje të Ukrainës dhe në sanksionimin e Rusisë", ka deklaruar shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Ai ka theksuar se Bashkimi Evropian deri tash ka ndarë mbi 4 miliardë euro ndihmë humanitare dhe rreth 1.5

miliard euro për siguri dhe mbrojtje në Ukrainë. Në ceremoni ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i lartë të kontingjentit ukrainas në KFOR, Ivan Nastenka. Ai shprehu falënderimin e tij të thellë dhe tha se emocionet e tij janë të përziera. "Emocionet e mia janë të përziera, në njërin anë ndihem i turpëruar që jam këtu përderisa shokët e mi janë duke e rrezikuar jetën për Ukrainën. Në anën tjetër, jam shumë krenar sot që jam këtu dhe shërbej para partnerëve ndërkombëtarë, që gjithmonë janë të gatshëm të ndajnë barrën me çfarë i dërgojnë një mesazh të qartë gjithë botës së Ukraina nuk është e vetme në këtë luftë", ka thënë Nastenka.

Nuk miratohet Projektligji për rregullimin e çmimit të produkteve medicinale

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nuk e ka miratuar Projektligjin për rregullimin e çmimit të produkteve medicinale. Deputetja e PDK-së, Florentë Zejnullahu, e cila prezantoi nismën ligjore për këtë projektligj, tha se ai është shumë i nevojshëm për qytetarët që janë dëmtuar në mungesë të tij. "Buxheti i shtetit dhe qytetarët janë dëmtuar. 6 milionë euro brenda vitit kanë blerë barna qytetarët. Qytetarët duhet të mos blejnë barna me çmime të larta. Çmimet e barnave duhet të jenë të njëjta në secilën barnatore. Shpresoj ta rregullojmë këtë fushë", ka thënë ajo. Për këtë, deputeti i LV-së,

Haxhi Avdyli, ka thënë se marzha e fitimit është tanimë e përcaktuar dhe se ligji është kryer në ministri. "Unë kam edhe ligjin që është kryer në ministri dhe brenda disa ditëve vjen edhe në komision. Më shumë ka zhargon të fjalëve por nuk pashë se sa do të jetë marzha. Është përcaktuar me ligj marzha e fitimit. Besoj se këtu mund të gjendet një gjuhë e përbashkët dhe të amandametohej", ka thënë Avdyli. Ndërsa, deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, kritikoi Qeverinë për shtyrjen e kësaj nisme. "Nisma ligjore ka filluar në muajin mars. Qëllimisht është shtyrë nga Qeveria. Ka mbetur vetëm në agjendë. Më vjen mirë që kjo iniciativë e



jona të ketë angazhuar dikë në Ministri të Shëndetësisë. Nëse ka qeveria draft mundet me e inkorporua mes dy leximeve. Qëllimi është me e rregullua këtë sektor në aspektin ligjor", ka thënë Haxhiu.

Edhe Armend Zemaj, deputet nga radhët e LDK-së ka thënë se ky projektligj do të ishte i nevojshëm për qytetarët. "Mirë është të rregullohet kjo fushë me ligj. Këtu ka të involvuar edhe sektorë tjerë.

Mes dy leximeve Qeveria duhet të implikohet edhe nëse sjellë draftin vet. Kanë kaluar katër muaj që ky ligj është i gatshëm. Mendoj që duhet t'i japim përkrahje në parim", ka thënë Zemaj.

Vlora e boshatisur në mes të sezonit turistik, shkak çmimet e larta

Vlorë, 12 korrik- Mesi i korrikut e gjen Vlorën gati të zbrazët nga turistët. Plazhet e qytetit thuajse janë bosh ndërsa hotelet nuk i kalojnë 50 për qind të kapaciteteve. Për pushuesit shqiptarë në zona të ndryshme çmimet ndryshojnë, por sërish mbeten të shtrenjta. Për turistët e huaj, çmimet janë të ulëta në krahasim me vendet e tyre, por sërish të larta për Shqipërinë. Vetë menaxherët e hoteleve konfirmojnë se sezoni

është i vakët. Çmimet për një natë shkojnë deri në 350 euro. “Kemi një ndryshim të çmimeve rreth 20- 30 për qind, konkretisht nëse çmimi i një dhomë çift shkonte deri në 60 euro sivjet shkon deri në 80 euro. Një dhomë triple shkonte 90 euro sivjet shkon 110 euro. Sa i përket prenotimeve, vjet në datën 8 korrik nisi fluksi i madh, sivjet jemi duke pritur ende”, thonë përfaqësues të hoteleve.

Për kreun e sektorit hotelier për jugun, Adnand Aliaj prenotimet janë në 50 për qind të pritshmërive. Problematikë mbeten çmimet e larta. Çmimi i shezlongëve nis nga 500 lekë në zonën e Lungomare për të vijuar me 1 000 deri në 2 000 lekë, duke u zhvendosur gjatë vijës bregdetare. Rritja e çmimeve duket se po tkurr kohëzgjatjen e sezonit. Pritshmëritë për muajin korrik janë nën mesatare.



ATK-ja për gjashtë muaj mblodhi 76.8 milionë euro borxhe

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 12 korrik- Niveli i lartë i inkasimit të të hyrave, rritja e efektit në trajtimin e borxheve, orientimi në përmirësimin e përmbushjes tatimore, ishin vetëm disa nga pikat e prezantuara në konferencë për media, si të arritura në institucionin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për gjashtë muajt e parë të këtij viti. Në këtë konferencë ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka përgëzuar ATK-në dhe stafin për arritjet e bëra në gjashtëmuajorin e këtij viti, po ashtu ka falënderuar edhe tatimpaguesit për kontributin që japin në zhvillimin e vendit duke paguar tatimet.

Murati u shpreh se për të rritur edhe më shumë suksesin e ATK-së duhet të punohet në rritjen e besimit.

Ai ka thënë se planet e ministrisë janë që të forcojnë institucionet, duke rritur kredibilitetin dhe profesionalizmin, pasi që vetëm në këtë mënyrë do të rritet edhe më shumë besimi ndaj institucioneve, në këtë rast ATK-së.

Veç tjerash, ministri Murati ka thënë se është i rëndësishëm formalizmi i ekonomisë, për të cilën ATK-ja është duke zhvilluar kampanja sensibilizuese.

Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, gjatë prezantimit të konferencës përmendi faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e të hyrave, si ajo e fuqizimit të kontrollit të brendshëm (ngritja e përgjegjësisë dhe



llogaridhënies), rritja e efikasitetit në mbledhjen e borxheve, digjitalizimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve 100%, shërbimet profesionale, rritja e transparencës, rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si

dhe zbatimi i rekomandimeve nga organizatat ndërkombëtare. Murtezaj ka theksuar se inkasimi prej 355.5 milionë euro tatime, ka shënuar rritje në krahasim me planin për 26.5 milionë euro apo 8.1%. Po ashtu, në krahasim me periudhën e

njëjtë të vitit të kaluar ka rritje për 66.3 milionë euro apo 22.9%. Përmes kësaj konference u prezantuan edhe efektshmëria në trajtimin dhe inkasimin e borxheve, ku vetëm për këtë periudhë janar-qershor 2022 janë mbledhur 76.8 milionë

euro borxhe.

Tutje, u theksua se digjitalizimi i shërbimeve si për tatimpagues dhe qytetar, ashtu edhe me institucionet bashkëpunuese janë indikator i rëndësishëm në realizimin e synimeve të institucionit.

Shtohet frika që në Evropë mund të rritet inflacioni

PRISHTINË, 12 KORRIK- Ministrat e financave të Eurozonës u takuan për të diskutuar rritjen e inflacionit.

Inflacioni në rritje është “një fakt i jetës” i përkeqësuar nga lufta në Ukrainë, ka thënë Sigrid Kaag, ministrja e financave të Holandës. “Nivelet e inflacionit sigurisht që do të jenë me ne në një nivel të lartë

viti e ardhshëm dhe ne duhet ta marrim këtë parasysh”, tha Kaag.

Disa kanë frikë se Evropa mund të hyjë në një recesion pasi lufta në Ukrainë rrit çmimet për energjinë, ushqimin dhe lëndët e para, raporton Euronews. “Ajo që mund të ndryshojë situatën në të cilën ndodhemi dhe të na

sjellë në një situatë më të vështirë ekonomike janë shkurtimet e furnizimit dhe mungesat reale të furnizimit”, tha Komisioneri i BE-së për Ekonominë, Paolo Gentiloni. Për muajt të tërë BE-ja ka paralajmëruar vendet anëtare që të përgatiten për një mbyllje të plotë të furnizimit me energji nga Rusia.



A kemi nevojë për një Teori të re të Evolucionit?

Nga Stephen BURANYI

Sado e çuditshme që mund të tingëllojë, shkencëtarët nuk i dinë ende përgjigjet e disa prej pyetjeve më themelore se si evoluoi jeta në Tokë. Për shembull marrim rastin e syve. Nga vijnë saktësisht ato? Shpjegimi i zakonshëm se si i kemi marrë këto organe tejet komplekse mbështetet në teorinë e përzgjedhjes natyrore. Ju mund ta mbani mend thelbin nga leksionet e biologjisë në shkollë. Nëse një krijesë me shikim të dobët ndodh që të prodhojë pasardhës me shikim pak më të mirë, falë mutacioneve të rastësishme, atëherë ky shikim pak më i mirë u jep atyre më shumë mundësi për të mbijetuar.

Sa më gjatë të mbijetojnë, aq më shumë shanse kanë për t'u riprodhuar, dhe për t'ua përcjellë brezave të tjerë gjenet që i pajisën me një shikim pak më të mirë. Nga ana tjetër disa nga pasardhësit e tyre, mund të kenë shikim më të mirë se prindërit e tyre, duke e bërë më të mundshëm riprodhimin e tyre. E kështu me radhë.


Brez pas brezi, gjatë periudhave kohore shumë të gjata, shtohen avantazhe të vogla. Në fund, pas disa qindra milionë vitesh, kemi krijesa që mund të shohin po aq mirë sa njerëzit, macet ose bufat. Kjo është historia bazë e evolucionit, siç tregohet në shumë libra shkollorë dhe libra shkencorë bestseller.

Por sipas një numri gjithnjë e më të madh shkencëtarësh, kjo teori është shumë përgjithësuese dhe për pasojë e pasaktë në shumicën e rasteve. Së pari, në rastin e syve historia nis në mes, duke marrë të mirëqenë ekzistencën e qelizave të ndjeshme ndaj dritës, lenteve dhe irisit, pa shpjeguar fillimisht se nga erdhën ato.

Dhe nuk janë vetëm sytë. "Syri i parë, krahu i parë, placenta e parë. Si janë krijuar ato? Shpjegimi i tyre është motivimi themelor i biologjisë evolucionare. Por ne nuk kemi ende një përgjigje të mirë. Ideja klasike e ndryshimit gradual, ka rënë tashmë" - thotë Armin Mozek, biolog në Universitetin e Indianës, SHBA.

Sigurisht, ka ende disa parime thelbësore evolucionare, të cilat nuk vihen në dyshim nga asnjë shkencëtar. Kështu të gjithë pajtohen se përzgjedhja natyrore luan një rol tek evolucionit, ashtu si mutacioni dhe rastësia. Por se si bashkëveprojnë saktësisht këto procese, dhe nëse kanë rol edhe forca të tjera, kjo mbetet objekt i debateve të forta.

"Në rast se nuk mundemi që t'i



shpjegojmë dot gjërat me mjetet që kemi tani, ne duhet të gjejmë mënyra të reja" - më tha biologu i Universitetit të Jeilit në SHBA, Gynter Vagner. Në vitin 2014, 8 shkencëtarë vendosën që të përballen me këtë sfidë. Ata botuan një artikull në revistën "Nature" me pyetjen "A ka nevojë për rishikim Teoria e Evolucionit".

Përgjigja e tyre ishte: "Po, dhe urgjentisht madje". Secili prej autorëve vinte nga disiplina shkencore të dekadave të fundit, nga studimi i mënyrës se si organizmat e ndryshojnë mjedisin e tyre, që të reduktojnë presionin normal të përzgjedhjes natyrore - mendoni pak për kastoret që ndërtojnë diga - deri te kërkimet e reja, të cilat tregojnë se modifikimet kimike të shtuara në ADN gjatë jetëve tona mund t'u kalojnë pasardhësve tanë.

Autorët kërkuan një kuptim të ri të evolucionit, që mund të krijonte hapësirë për zbulime të tilla. Emri që ata i dhanë këtij kuadri të ri ishte Sinteza e Zgjeruar Evolucioniste (EES). Por për shumë kolegë propozimet e tyre ishin të diskutueshme. Pas debatit aktual mbi evolucionin qëndron një ëndërr e thyer.

Në fillimin e shekullit XX-të, shumë biologë kërkuan për një teori unifikuese, që do të mundësonte bashkimin e fushës së tyre me fizikën dhe kiminë. Nga këndvështrimi i sotëm, është qartë se Teoria e Evolucionit e Darvinit - një teori e thjeshtë, elegante që shpjegon se si një forcë, apo përzgjedhja natyrore, i dha formë të gjithë zhvillimit të jetës në Tokë - dhe do të luante rolin e unifikuesit të madh.

Por në fillim të shekullit të kaluar, 4 dekada pas botimit të librit "Mbi origjinën e specieve", dhe 2 dekada pas vdekjes së tij, idetë e Darvinit ishin në rënie. Shkencëtarët nuk e kishin humbur interesin për evolucionin, por shumë prej tyre e cilësuan si të pamjaftueshëm rrëfimbin e Darvinit për të.

Një problem i madh ishte se i mungonte shpjegimi i trashëgimisë. Darvini kishte vënë re se me kalimin e kohës, gjallesat dukej se ndryshonin për t'iu përshtatur më mirë mjedisit të tyre. Por ai nuk e kuptoi se si këto ndryshime kalonin nga një brez tek tjetri. Në fillim të shekullit XX-të, rizbulimi i punës së priftit të shekullit XIX-të dhe babait të gjenetikës, Gregor Mendel, filloi që të japë përgjigjet. Shkencëtarët që punojnë në fushën e re të gjenetikës, zbuluan rregulla që rregullonin veçoritë e trashëgimisë. Por në vend se ta konfirmonin teorinë e Darvinit, ata e ndërlikuan atë. Riprodhimi dukej se i ripërzierte gjenet - njësitë misterioze që programojnë tiparet fizike - në mënyra të habitshme. Mendoni pak se si flokët e kuq të gjyshit, mungojnë tek djali i tij, por mund të rishfaqen tek mbesa e tij.

Një zhvillim edhe më shqetësues për darvinistët ishte shfaqja e "mutacionistëve" në vitet 1910, një shkollë gjenetistësh, ku figura kryesore e saj, Tomas Morgan, tregoi se duke mbarështuar miliona miza frutash - dhe duke e spërkatur nganjëherë ushqimin e tyre me elementin radioaktiv radium - ai mund të prodhojë tipare të ndryshuara si ngjyra të reja të syve apo gjymtyrë shtesë.

Këto nuk ishin variacionet e vogla të rastësishme mbi të cilat u ndërtua teoria e Darvinit, por ndryshime të papritura, dramatike. Dhe rezultoi se këto mutacione ishin të trashëgueshme. Mutacionistët besonin se kishin identifikuar forcën e vërtetë krijuese të jetës. Sigurisht, përzgjedhja natyrore ndihmoi për të zhdukur ndryshimet e papërshtatshme. Por ajo ishte thjesht një redaktuese e zhurmshtëm e poezisë së mrekullueshme të mutacionit. "Natura non facit saltum", kishte shkruar një herë Darvini: "Natyra nuk bën kërcime". Mutacionistët u lutën që gjërat të ndryshonin. Në vitet 1920-1930, duke punuar veçmas, britaniku Ronald Fisher dhe blegtori amerikan Siuoll Rajt, propozuan një teori të rishikuar të evolucionit, që përmbledhte përparimet shkencore që nga vdekja e Darvinit, por që premtoi ende të shpjegonte të gjitha misteret e jetës me disa rregulla të thjeshta. Në vitin 1942, biologu anglez Xhulian Haksli shpiku emrin për këtë teori: sinteza moderne. Tetëdhjetë vjet më vonë, ajo ofron ende kuadrin bazë për biologjinë evolucionare, pasi u mësohet çdo vit miliona nxënësve dhe studentëve. Duke ndërtuar modele statistikore të popullatave të kafshëve që bazoheshin tek ligjet e gjenetikës dhe mutacioneve, sintetistët modernë treguan se gjatë periudhave të gjata kohore, përzgjedhja natyrore funksiononte ende siç kishte parashikuar Darvini.

Në tërësinë e kohës, mutacionet ishin shumë të rralla për të qenë të rëndësishme, dhe rregullat e trashëgimisë nuk ndikuan në fuqinë e përgjithshme të


seleksionimit natyror. Përmes një procesi gradual, gjenet me avantazhe u ruajtën me kalimin e kohës, ndërsa të tjerët që nuk jepnin përparësi u zhdukën. Por shumë shpejt, edhe sinteza moderne do të kritikohet nga shkencëtarët brenda departamenteve që kishin ndihmuar në hartimin e kësaj teorie. Në vitin 1959, biologu C.H. Uadington tha se sinteza moderne kishte anashkaluar teorinë e vlefshme, në favor të "thjeshtimeve drastike që mund të na çojnë në një pamje të rreme se si funksionon procesi evolucionar".

Pastaj nga fundi i viteve 1960 erdhën disa zbulime të reja, që vunë në pikëpyetje themelet e teorisë. Ndërsa sintetistët modernë e shikonin jetën sikur përmes një teleskopi, duke studiuar zhvillimin e popullsisë të mëdha në periudha kohore të pafundme, biologët molekularë e panë atë përmes një mikroskopi, duke u fokusuar tek molekulat individuale.

Ata zbuluan se përzgjedhja natyrore nuk ishte forca e gjithëfuqishme që kishte supozuar shumëkush, dhe zbuluan se molekulat në qelizat tona - dhe kësajsoj edhe sekuencat e geneve pas tyre - po ndryshonin me një shpejtësi shumë të lartë.

Biologu Eugjen Kunin, mendon se njerëzit duhet të mësohen me teorinë që nuk përshtaten së bashku. "Për mendimet tona nuk ka - nuk mund të ketë - një teori të vetme të evolucionit. Nuk mund të ketë një teori të vetme për gjithçka. Edhe fizikantët nuk kanë një teori për gjithçka" - thotë ai.

Marrë me shkurtime nga "The Guardian" - Bota.al



16 lojtarë rinovojnë kontratat me Dukagjinin, 9 të tjerë largohen

KLINË, 12 KORRIK - Skuadra e Dukagjinit nga Klina është treguar mjaft aktive, duke bërë disa risi në skuadër. Ky klub, që do të bëjë gara në Superligë edhe në edicionin e ri, nëpërmjet një njoftimi për medie ka konfirmuar se disa lojtarë kanë rinovuar kontratat, ndërsa disa të tjerë janë larguar dhe dy të tjerë janë huazuar. "Kontratat i kanë vazhduar këta futbollistë: Altin Merlaku, Altik Muhaxhiri, Kenan Haxhihamza, Arbër Shala, Ardin Dallku, Ilir Sylja, Elton Basriu, Ahmed Januzi, Ergyn Ahmeti, Melos Zenunaj, Vitor Hugo, Labinot Jashanica, Rion Selimi, Met Millaku, Granit

Elezaj dhe Henry Chibueze. Nga akademja e klubit është bashkuar Vlerson Berisha. Ndërsa largimet me marrëveshje të dyanshme, që njëkohësisht i falënderojmë për bashkëpunim, janë: Stefan Nikoliq, Victor Lindenberg, Bujar Shabani, Mark Milicaj, Donat Hasanaj, Mentor Zhdrella, Dren Gashi, Jean Carioca dhe Liridon Palushaj, për arsye familjare. Gjithashtu, janë huazuar dy futbollistët e rinj: Art Zenunaj dhe Abedin Merlaku", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Skuadra nga Klina ka njoftuar se shumë shpejt do të ketë risi edhe sa iu përket përforcimeve për edicionin 2022/23.



Rivera, edhe një vit pjesë e Llapit



PODUJEVË, 12 KORRIK - Skuadra e Llapit ka njoftuar se ka rinovuar kontratën me futbollistin Francisco Rivera. Meksikani Rivera ka vendosur ta firmosë kontratën e re me skuadrën e Llapit. Mesfushori me tipare ofensive, Rivera, do të jetë me skuadrën e Llapit edhe për një vit tjetër. Lajmin e ka konfirmuar faqja zyrtare e skuadrës së Llapit. Rivera pati 31 paraqitje në sezonin e kaluar, duke shënuar 8 gola dhe 2 asistime. "Francisco Rivera rinovon edhe për një vit me Llapin. Mesfushori ofensiv më i vlerësuar në Superligë, meksikani Francisco Rivera, ka vazhduar bashkëpunimin me klubin

tonë edhe për edicionin e ardhshëm. Ky rinovim me Riveran është i mirëseardhur në prag të ndeshjes shumë të rëndësishme ndaj Budućnost Podgoricës që skuadra jonë do ta zhvillojë më 14 korrik në stadiumin 'Fadil Vokrri'. Rivera ishte ndër futbollistët më të mirë të ekipit tonë në stinorin e kaluar duke arritur të zhvillojë 31 paraqitje, 8 gola të realizuar e 2 asistime në gjithsejtë 2.313' minuta të zhvilluara. Vizioni i lojës nga Rivera, mençuria e tij dhe qetësia para golit, janë disa nga karakteristikat që e bëjnë atë ndër mesfushorët më të mirë në Superligën tonë", thuhet në njoftimin e Llapit.

Broja, objektivi kryesor i West Hamit



LONDËR, 12 KORRIK - Sulmuesi shqiptar i Chelseas, Armando Broja, është objektivi kryesor i West Hamit. Sulmuesi kuqezi, pas performancës së shkëlqyer në sezonin e fundit të Southamptoni në formë

huazimi nga Chelsea, tashmë është një nga lojtarët më të kërkuar gjatë tregut të kësaj vere. Mediet britanike raportojnë se Broja është synimi kryesor i West Hamit. Krerët e kësaj skuadre do t'i rinisin shumë shpejt

negociatat me 'Blutë' e Londrës për transferimin e mundshëm të sulmuesit shqiptar. Broja në sezonin e kaluar me Southamptonin mbylli huazimin me nëntë gola në 38 paraqitje. Ai u kthye në "Stamford Bridge"

duke shpresuar për të gjetur një vend në ekipin e parë, por kjo duket e pamundur pavarësisht prej largimit të Romelu Lukakut. West Hami thuhet se është opsioni më i mundshëm për reprezentuesin e Shqipërisë.

Bajrami, trajner i ri i Ulpianës

Lipjan, 12 korrik - Skuadra e Ulpianës duket se ka lënë anash krizën që kishte dhe pas zgjedhjes së kryesisë së re tashmë ka nisur të konsolidohet. Presidenti i

klubit, Jeton Gashi, ka paraqitur edhe trajnerin e ri, pozitë kjo që i është besuar Emin Bajramit. Ai tek Ulpiana shkon me synime për ta rikthyer skuadrën në

shoqërinë elite, status këtë që e humbi vitin e kaluar kur u largua nga Superliga. "Nga sot jam kryetrajner i KF Ulpiana. Falënderoj presidentin e klubit për

besimin dhe vlerësimin! Tifozëve të klubit Ulpiana ju premtoj se do të ndërtojme një ekip konkurrues dhe me mentalitet fitues", ka shkruar Bajrami në "Facebook".



Federeri sinjale lamtumire: Tani më lumturojnë vetëm fëmijët

CYRIH, 12 KORRIK - Roger Federer prej 12 muajve vuan një dëmtim në gju i cili e ndalon të marrë pjesë në kompeticionet më të rëndësishme të tenisit. Si pasojë, për herë të parë në histori zvicerani ka rënë poshtë 1000 të parëve në renditjen ATP, ndërsa

së fundmi shfaq sinjale lamtumire nga ky sport teksa thekson se tashmë e lumturon vetëm djali dhe vajza e tij. "Unë jam një person që e dashuron fitore, por kur nuk je më konkurrues atëherë e mira është të ndalosh. Mendoj se nuk kam

më nevojë për tenis. Tani më gëzon djali i vogël apo vajza kur merr ndonjë notë të mirë në shkollë. Tenisi është pjesë e imja, por nuk më identifikon më. Dua të mbetem i suksesshëm dhe kam hedhur shumë energji në botën e biznesit. E di se një

karrierë profesionisti nuk mund të zgjasë përgjithmonë dhe kjo është në rregull. Ishte e çuditshme ta shihja Wimbledon nga shtëpia, pasi kam qenë pjesë e turneut prej vitit 1998. Ndonjëherë më mungon të shëtis botën si sportist, por le të



themi se edhe jeta në shtëpi nuk është keq", u shpreh 40-vjeçari.

Rrëfimi tronditës i kampionit olimpik: Në Angli më kanë trafikuar kur isha 9 vjeç

LONDËR, 12 KORRIK - Një rrëfim tronditës ai i bërë nga atleti britanik Mo Farah, kampion olimpik i garave të 5 dhe 10 mijë metrave. Ai ka pranuar se ka mbërritur në Britaninë e Madhe jo me prindërit e tij, si emigrant nga Somalia, siç ka deklaruar gjithnjë, por në mënyrë ilegale, i trafikuar nga Xhibuti, në moshën 9-vjeçare. "Kur isha 8 apo 9 vjeç, më kanë marrë nga shtëpia ime dhe më dërguan në Gibuti. Më pas, më dërguan me avion në Angli, i shoqëruar nga një grua që nuk e njihja, nuk e kisha parë më parë. Ajo më ka thënë se do të shkonim në Evropë për të jetuar me prindërit e mi", kujton Mo Farah gjatë intervistës për BBC. "Ajo grua kishte me vete dokumente false për të udhëtuar, ku në ato shkruhej emri Mohamed Farah. Më pas, ajo grua më dërgoi në apartamentin e saj në Perëndim të Londrës. Ajo kishte një copë letër me detajet e prindërve të mi, të cilën e grisi dhe e hodhi në kosh. Aty kuptova se isha në telashe", ka



shtuar Mo Farah. "Këtë emër që kam dhe më njohin të gjithë ma dhanë personat që më trafikuan në Angli. Emri im i vërtetë është Hussein Abdi Kahin. Ajo grua më kërcënonte dhe më duhej të heshtja, ndërkohë që bëja punë shtëpie për të jetuar. Jeta ime ndryshoi kur të gjitha ia tregova mësuesit tim të edukimit fizik, Alan

Watkinson", shprehet atleti britanik. "Atij i thashë për identitetin tim, për familjen dhe faktin që isha i detyruar të punoja. Ai kontaktoi me shërbimin social, duke më ndihmuar dhe iu besova një familje nga Somalia. Familja ime s'ka qenë kurrë në Angli. Ata jetojnë në një fermë në Somali dhe babai im është vrarë", ka deklaruar Mo Farah.

Manaj vazhdon karrierën në Angli

WATFORD, 12 KORRIK - Rey Manaj është zyrtarizuar te klubi i Watford teksa sulmuesi i kombëtares do të nisë për herë të parë në karrierën e tij një aventurë në Angli, edhe pse jo në Premier Ligë, por në Championship. Pas eksperiencës së kaluar në Serie A te Spezia, Manaj u rikthye te Barcelona klubi që kishte në pronësi kartonin e tij. Megjithatë, spanjollët nuk e kishin të përfshirë në projektin e tyre shqiptarin dhe në këtë formë, anglezët e Watford nisin bisedimet që tashmë janë mbyllur me sukses. Vlen të theksohet se Barcelona ende nuk është një shkëputur totalisht nga Manaj duke qenë se klubi spanjoll ruan të drejtën për të refuzuar ofertën e parë që mbërrin në klubin e Watford në rast shitje të



futbollistit, ndërsa gjithashtu, katalanasit përfitojnë 50% të shumës në qoftë se anglezët shesin diku tjetër kartonin e 25-vjeçarit, raporton "SS". "Jemi shumë të lumtur të

konfirmojmë nënshkrimin me lojtarin e kombëtares së Shqipërisë, sulmuesin Rey Manaj që vjen nga Barcelona", shkruhej në njoftimin e Watford në "Twitter".

Terry 'tradhton' Chelsea: Jam tifozë dhe e dua Barcelonën

Ish-kapiteni dhe ish-qendërmbrojtësi i Chelseat dhe ndihmës-trajneri aktual i Aston Villas, John Terry, duke iu përgjigjur disa pyetjeve të ndjekësve të tij në "Instagram",

zbuloi se ishte tifoz i Barcelonës dhe deklaroi publikisht dashurinë e tij për klubin blaugrana. Pyetjet dhe përgjigjet e anglezit janë raportuar nga "Mundo Deportivo", që ka

shpjeguar si ka shkuar biseda e Terryt me ndjekësit e tij. Pyetjes nëse ishte një tifoz i Barcelonës, Terry i është përgjigjur: "Ishte shumë e qartë. Nuk është sekret. Po, jam.

Unë e dua Barcelonën". Terry ka shtuar gjithashtu se skuadra më e mirë kundër të cilës kam luajtur ndonjëherë ishte ajo "Blaugrana": "Lehtësisht skuadra më e mirë e brezit tim". Duke folur për

stadiumet më të mira ku ka luajtur, ish-kapiteni i "bluve" renditi "Stamford Bridge" dhe "Wembley", por edhe "Camp Nou", ku u përball me Leo Messin dhe Ronaldinon.

SHKURT

Nani arrin marrëveshje me Melbourne Victory

Luis Nani nënshkroi një kontratë dyvjeçare me klubin australian Melbourne Victory. Sulmuesi portugez, i cili është 35-vjeçar, fitoi katër herë Premier Ligë dhe njëherë Ligën e Kampionëve me Manchester United. Ai transferohet në Australi pasi luajti për skuadrën italiane Venezia. "Me sa kam parë, tifozët në Melburn nuk janë vetëm më të mirët në ligë, por ata rivalizojnë atmosferën në Evropë dhe mezi pres të jem pjesë e kësaj në fushë me një fanellë të Victory dhe të luaj për ta këtë sezon", ka thënë Nani.

Mançini deri në vitin 2027 pjesë e Romës

Gianluca Mançini ka rinovuar kontratën me skuadrën e Romës. Mbrojtësi italian do të jetë në "Stadio Olimpico" deri në vitin 2027, pra për pesë vite të tjera. 26-vjeçari vinte te "Giallorossi" në vitin 2019 nga skuadra e Atalantas në formë huazimi, para se lëvizja të bëhej permanente vitin e kaluar, për 13 milionë euro. Lojtari ka luajtur 128 herë me skuadrën e Romës dhe ka shënuar shtatë gola. Ai ishte startues edhe në finalen e Ligën e Konferencës. Mbrojtësi ka edhe nëntë paraqitje me kombëtaren e Italisë, që kur debutoi në vitin 2019.

PSG-ja do t'i largojë 10 lojtarë

Një nga premiset kryesore të drejtorit të ri Luis Campos me ardhjen te PSG-ja është të largojë disa futbollistë. Për ta bërë këtë, ai ka përjashtuar dhjetë lojtarë për fazën verore që skuadra parisienë do të zhvillojë në Japoni nga data 16 deri më 25 korrik. Një dëshmi e qartë se duhet të gjejnë një rrugëdalje nga klubi sa më shpejt të jetë e mundur. Sipas "L'Equipe", lista përbëhet nga: Mauro Icardi, Layvin Kurzawa, Julian Draxler, Ander Herrera, Georginio Wijnaldum, Eric Junior Dina-Ebimbe, Abdou Diallo, Sergio Rico, Rafinha dhe Idrissa Gueye. Dhjetë lojtarët që PSG-ja ka përjashtuar janë aktualisht në listën e transferimeve dhe qëllimi i Luis Campos është që para fillimit të Ligue 1, të planifikuar për 6 gusht, e ardhmen e tyre të jetë zgjidhur.

Rodri rinovon me Cityn

Manchester City ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me Rodrin për rinovimin e kontratës. Kampioni në fuqi i Ligës Premier e ka blinduar mesfushorin në një kontratë deri në vitin 2027. "Rodrigo ka nënshkruar një zgjatje të re trevjeçare të kontratës së tij me Manchester Cityn, një marrëveshje që do të thotë se 26-vjeçari do të qëndrojë në klub deri në qershor 2027", thuhet në njoftimin e tyre. "Mesfushori, i cili është përmirësuar vazhdimisht që kur iu bashkua Cityt në verën e vitit 2019, ka bërë 151 paraqitje në tre sezonet e tij në 'Etihad' dhe ka 33 paraqitje ndërkombëtare për Spanjën. Ai thotë se e ka adhuruar kohën e tij te City dhe mendon se është vendi më i mirë për të që të vazhdojë të zhvillojë lojën e tij", thuhet në njoftimin e tyre.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 12.07.2022 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-22-05

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirës në Industrinë Kimike dhe FPP
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes: 12.07.2022
Sqarimi: deri me 22.07.2022
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 22.07.2022
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit: 25.07.2022 në 15:00
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		

Ne, **Feyzula Fusha** me nr personal 1006484570 dhe **Masar Fusha** me nr personal 1006444551, që të dy nga Prizreni, përfaqësuar me autorizim nga Avokat Alija Ajro nga Prizreni, me përgjegjësi morale dhe ligjore:

LAJMËROJMË

Bashkëpronarin "EUROFOOD" SH.P.K, me seli në Prizren, si blerësin potencial se si bashkëpronar ligjor me nga ¼ e pjesës ideale në ngastrën kadastrale me nr. P-71813068-07055-0 ZK Prizren, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1295 m², në vendin e quajtur "Atmejdani", se **pjesët tona bashkëpronësore të paluajtshëmrisë së lartcekur, po i SHESIM në tërësi nga parcela me nr. P-71813068-07055-0.**

Në këtë mënyrë i ofrojmë bashkëpronarit "Eurofood" SH.P.K, po që se është i interesuar për blerje, të lajmërohet në afat prej 30 dite në adresën e të autorizuarit tonë.

Gjithashtu, ju njoftojmë se kemi blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 dite është i gatshëm të paguaj çmimin e përgjithshëm prej 633,750.00 € (gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro), me para të gatshme – në kesh.

Prizren

Dt.12.07.2022

I autorizuari


Av. Alija Ajro
Rr."De Rada" nr.4
+383 48 653 031


NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Magic Kids" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811884528 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Magic Kids" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811884528 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Magic Kids" L.L.C. Pristina, has come to the decision to quit its business: 811884528 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Mustafa Arifi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.
- ▶ Bujar Badalli shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.
- ▶ Shani Thaqi shpall te pavlefshme diplomen shmit "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Indrit Gashi shpall te pavlefshme diplomen shmit "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Leonora Susuri nga Zhuri i Prizrenit, shpall të pavlefshme diplomën e UGJ "Fehmi Agani", dega: Infermieri e Përgjithshme me nr: 525.
- ▶ Denisa Hajdari shpall të pavlefshme dëftesat e klasës -X-, -XI-, -XII- si dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- ▶ Shkumbin Shehu B.I. Emri tregtar: N.T.P. "Tre Yje Design" me NUI: 811485516 me seli në Prishtinë, Adresa: Rr. Ndue Perlleshi, Pn Mati 1 shpall të pavlefshme Certifikatën e TVSH-se me numër të TVSH-së: 330032897 me datë të lëshimit: 18.09.2008 të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

